



Erteilung eines Visums zum Ehegattennachzug / zur Eheschließung

Die Botschaft weist ausdrücklich darauf hin, dass sämtliche Unterlagen (Merkblätter, Antragsformulare) der Botschaft kostenlos sind. Auslagen, z.B. Telefon- und Faxkosten, sind zu erstatten. Weiter wird darauf hingewiesen, dass die Bestechung bzw. der Versuch der Bestechung von Mitarbeitern der Botschaft neben den strafrechtlichen Konsequenzen ebenfalls die Versagung des Visums zur Folge hat.

Die Botschaft muss im Visumverfahren die zuständige Ausländerbehörde in Deutschland beteiligen. Das Verfahren dauert daher in der Regel mindestens zwei Monate, meistens erheblich länger. Es wird daher um Verständnis gebeten, dass Sachstandsanfragen innerhalb der ersten 8 Wochen ab Antragstellung nicht beantwortet werden können. Bitte machen Sie vom Service des Dienstleisters DHL Gebrauch und erwerben Sie vor Antragstellung für 10 Euro einen Rücksendeumschlag. Eine zweite Anreise zur Abholung des Reisepasses ist dann nicht mehr nötig.

Für die Erteilung eines Visums zum Ehegattennachzug oder zur Eheschließung gilt für beide Ehegatten ein Mindestalter von 18 Jahren.

Im Rahmen der persönlichen Vorsprache sind immer folgende Unterlagen vorzulegen:

- zwei vollständig in deutscher oder englischer Sprache in Druckbuchstaben oder Maschinenschrift ausgefüllte und eigenhändig unterschriebene Antragsformulare
- drei biometriefähige Passfotos (nicht älter als sechs Monate)
- Reisepass (noch mindestens sechs Monate gültig)
- Familienzertifikat (nicht älter als sechs Monate)
- sofern einer der Ehepartner schon verheiratet war sind die Scheidungsurteile aller Vorehen vorzulegen
- Reisekrankenversicherung (INCOMING), gültig für 3 Monate in einem Jahr, gültig ab Datum der Antragstellung

Für Ehegattennachzug:

- Geburts- und Heiratsurkunde jeweils mit Überbeglaubigungsstempel (nicht älter als 6 Monate und ggfs. [Legalisation](#))
- Falls einer der Ehegatten bei Eheschließung noch minderjährig war: Gerichtsbeschluss über die Zustimmung der Eltern zur Eheschließung
- aktuelle Meldebescheinigung des in Deutschland lebenden Ehegatten mit Passkopie und, wo zutreffend, Kopie des derzeit gültigen Aufenthaltstitels
- Nachweis elementarer Deutschkenntnisse

Für Eheschließung in Deutschland (mit anschließendem Daueraufenthalt):

- Geburtsurkunde mit Überbeglaubigungsstempel (nicht älter als sechs Monate und ggfs. [Legalisation](#))
- Bescheinigung der Anmeldung der Eheschließung des Standesamtes in Deutschland nach § 13 Abs. 4 PstG
- aktuelle Meldebescheinigung des in Deutschland lebenden Ehegatten mit Passkopie und, wo zutreffend, Kopie des derzeit gültigen Aufenthaltstitels
- Nachweis elementarer Deutschkenntnisse
- Verpflichtungserklärung gemäß §§ 66-68 Aufenthaltsgesetz aufgenommen von der Ausländerbehörde

Alle Unterlagen müssen im Original und mit zwei Schwarz-Weiß-Kopien vorgelegt werden. Bitte beachten Sie, dass nur vollständige Anträge entgegengenommen und bearbeitet werden können. Bitte fügen Sie jedem Dokument Ihres Visumsantrags eine Übersetzung ins Deutsche bei. Übersetzungen können nur von vereidigten Dolmetschern akzeptiert werden. Vollständigkeit der Unterlagen führt nicht automatisch zur Visumserteilung. Ge- oder verfälschte Unterlagen führen automatisch zur Ablehnung.

Die Gebühr in Höhe von EUR 75,00 ist bei Beantragung bar zu zahlen. Gebührenbefreiung gilt für Ehegatten von Deutschen und EU-Staatsangehörigen; hierauf ist zum Zeitpunkt der Antragstellung unter Vorlage geeigneter Nachweise hinzuweisen. Eine nachträgliche Gebührenerstattung ist nicht möglich. Bei Ablehnung – gleich aus welchem Grund - wird die Bearbeitungsgebühr nicht zurückerstattet. Außer der o.a. Gebühr und ggf. entstehenden Telekommunikationsauslagen entstehen keine weiteren Kosten – weder innerhalb noch außerhalb der Visastelle. Sollten Sie gleichwohl von Dritten gebeten werden, mehr zu zahlen, bitten wir um schriftliche Benachrichtigung möglichst unter ausführlicher Schilderung.

Adresse:

Rr. Azem Jashanica Nr. 66,
Dragodan II

10000 Pristina

Passausgabe:

je nach Vorgabe bei Antragstellung

Telefon:

Visastelle: +383-38-2545-77
Kanzlei: +383-38-2545-00

Telefax:

+49-(0)30-1817-67195

Internet:

www.pristina.diplo.de



Dhënia e vizës për bashkim familjar/për lidhje të martesës

Ambasada shpreh në mënyrë të qartë se të gjitha dokumentet (fletë-informacionet, formularët e aplikimit) e ambasadës janë pa pagesë. Shpenzimet, p.sh. të telefonit dhe faksit duhet kompenzuar. Përveç kësaj, ju bëjmë me dije se, korruptimi, gjegjësisht tentimi për të korruptuar bashkëpunëtorët e ambasadës përveç pasojave penale, do të ketë si pasojë edhe refuzimin e vizës.

Ambasada duhet të përfshijë entin përgjegjës për të huaj në Gjermani lidhur me procedurën e vizës. Për këtë arsye procedura zgjatë zakonisht së paku 2 muaj, në të shumtën e rasteve edhe shumë më gjatë. Prandaj ju lusim për mirëkuptim që kërkesat lidhur me ecurinë e lëndës tuaj nuk mund të përgjigjen brenda një afati prej 8 javësh nga data e aplikimit. Ju lutemi shfrytëzoni shërbimet e postës DHL dhe para se të parashtroni kërkesën, bleni një zarf kthyes me një çmim prej 10 €. Në këtë mënyrë nuk është më e nevojshme që të vini sërish për të marrë pasaportën tuaj të udhëtimit.

Për dhënien e vizës për bashkim familjar, apo për lidhje martesë mosha minimale për të aplikuar është mosha 18-vjeçare për të dy bashkëshortët.

Në kuadër të paraqitjes personale duhet çdo herë të parashtrohen dokumentet vijuese:

- 2 formularë të plotësuar tërësisht me shkronja të shtypit, ose makinë shkrimi në gjuhën gjermane apo angleze dhe të nënshkruar nga vetë aplikuesi
- 3 fotografi biometrike të pasaportës (jo më të vjetra se 6 muaj)
- Pasaporta valide e udhëtimit (me vlefshmëri së paku 6 muaj)
- Çertifikata familjare (jo më e vjetër se 6 muaj)
- Nëse njëri nga bashkëshortët ka qenë me herët i martuar, duhet të dorëzohen të gjitha aktgjykimet e shkurorëzimeve të mëhershme
- Sigurim shëndetësor i udhëtimit (INCOMING), i vlefshëm për 3 muaj brenda vitit, i vlefshëm nga data e aplikimit

Për tërheqjen e bashkëshortes/bashkëshortit:

- Çertifikata e lindjes dhe e martesës me vulë të verifikimit (jo më të vjetra se 6 muaj dhe [legalizimi](#))
- Nëse ndonjëri prej bashkëshortëve ka qenë i mitur gjatë lidhjes së martesës: Vendimi i gjykatës mbi pëlqimin e prindërve për lidhjen e kësaj martesë
- Çertifikata aktuale e vendbanimit nga bashkëshorti/ja që jeton në Gjermani, fotokopja e pasaportës dhe nëse kërkohet, edhe kopja e lejeqëndrimit të vlefshëm.
- Dëshmi mbi njohuri elementare të gjuhës gjermane

Për lidhje të martesës në Gjermani (më pas me qëndrim afatgjatë):

- Çertifikata e lindjes me vulë të verifikimit (jo më e vjetër se 6 muaj dhe [legalizimi](#))
- Vërtetimi i lajmërimit të lidhjes së martesës në zyrën e ofiqarisë në Gjermani
- Çertifikata aktuale e vendbanimit dhe kopja e pasaportës nga bashkëshorti apo bashkëshortja, i cili jeton në Gjermani dhe në qoftë se posedon leje të qëndrimit, atëherë një kopje të saj
- Dëshmi mbi njohuri elementare të gjuhës gjermane
- Fletëgarancioni/Ftesa në pajtim me §§ 66-68 të Ligjit për Lejeqëndrim i lëshuar nga Zyra për të Huaj

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në original dhe në 2 kopje bardh e zi. Ju lutem të keni parasysh se vetëm kërkesat e kompletuara do të pranohen dhe përpunohen. Ju lutemi t'i bashkangjitni një përkthim në gjuhën gjermane secilit dokument të nevojshëm për kërkesën për vizë. Pranohen vetëm përkthime nga përkthyes gjyqësorë. Kompletimi i dokumenteve nuk shpie automatikisht në dhënien e vizës. Dokumentet e falsifikura shpiejnë automatikisht në refuzimin e vizës.

Taksa në vlerë prej 75,00 € duhet të paguhet me para të gatshme gjatë parashtrimit të kërkesës. Lirimi nga pagesa e taksave vlen për bashkëshortë me shtetësi gjermane dhe qytetarë të Bashkimit Europian; gjatë aplikimit është e domosdoshme paraqitja e dëshmimeve përkatëse. Pagesa e mëvonshme e taksave nuk është e mundur. Me rastin e refuzimit të dhënies së vizës – për çfarëdo arsye refuzimi – taksa e paguar nuk kthehet. Përveç taksës së lartpërmendur, gjegjësisht shpenzimeve telekomunikative, nuk ekzistojnë shpenzime të tjera - qoftë brenda apo jashtë sektorit të vizave. Nëse kërkohet nga personi i tretë që të paguani më shumë, ju lusim të na njoftoni me shkrim, mundësisht sqarim të hollësishëm.

Adresa:

Rr. Azem Jashanica Nr. 66,
Arbëria II
10000 Prishtinë

Kthimi i pasaportave:

Sipas udhëzimeve gjatë aplikimit

Telefoni:

Seksioni i vizave: +383-38-2545-77
Ambasada: +383-38-25-45-00

Faksi:

+49-(0)30-1817-67195

Faqja e internetit:

www.pristina.diplo.de